



## PROCESVERBALI

Mbledhja e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) në Rahovec, e mbajtur më 22.05.2020 me fillim në ora 10.15. Mbledhjen e kryesoi Kryetari Komunës **Smajl Latifi**: Kuorum për mbajtjen e mbledhjes kemi.

**Kryetari**- Më lejoni ti përshëndes të gjithë të gjithë anëtarët e KKSBB, Nënkyetarin e komunës, Fatmir Iska, Drejtoret e Drejtive, komandantin e stacionit të policisë në Rahovecit z. Fazli Morina, Përfaqësues të Ushtrisë së Kosovës prezantë këtu që përfaqësojnë nga pikëpamja e sigurisë që kontribuojnë në komunën e Rahovecit, përfaqësuesit e mediave dhe gjithë të pranishmit e tjerë që janë prezent në sallë. Është mbledhja e rregullt e Këshillit komunal për siguri në Bashkësi. Përparrë e keni një rend dite i cili buron nga plani vjetor i punës për vitin 2020 i cili është aprovuar edhe në Kuvendin e Komunës. Ky është takimi i tretë për vitin 2019 i KKSBB-së. Për këtë mbledhje propozoj këtë:

## REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit,
  - Shqyrtimi i dukurive negative me theks të veçantë
  - trajtimi i objekteve jo të sigura në Komunën e Rahovecit,
  - Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla,
  - Rreth veprimeve dhe masave për luftimin e shkelësve të ligjit në komunën e Rahovecit,
  - Parapërgatitja dhe vetëdijesimi i qytetarëve për parandalimin nga zjarri gjatë sezonit veror,
3. Informatë rreth menaxhimit të situatës të krijuar nga Covid-19 nga Komuna e Rahovecit,
4. Identifikimi i çështjeve problematike që ndikojnë në sigurinë publike ndëretnike,
5. Të ndryshme.

**Kryetari** – Kjo pika apo nënpika: Monitorimi dhe raportimi mbi nivelin e sigurisë në shkolla dhe zbatimin e planit për siguri në shkolla, ndoshta me pak ka hapësirë ose mundësi që të diskutohet sot, për shkak të rrethanave të krijuara për shkak të pandemisë Covid-19, për arsyen të thjeshta sepse nuk kemi mësimdhënës dhe nxënës në shkolla pasi është ndërprerë procesi mësimor dhe nëse dikush nga ju pyet pse kjo pikë e rendit të ditës, pasi është planin vjetor të punës për vitin 2020 dhe ne nuk e kemi ditur që ka me pas pandemi këtë vit. A ka dikush ndonjë koment para se me hedhë në votim rendin e ditës.

**Fadil Sylka** – Unë desha një propozim rreth gjendjes në bujqësi dhe dëmet e shkaktuara, qe të shtohet si pikë e rendit të ditës, pasi e dimë që këto ditë kemi pasur vërvshime.

**Keyetari** – Faleminderit, ne kemi menduar si pikë në të ndryshme me bisedua por mund ta futim si pikë të veçantë s'ka asnjë problem, pasi kur ju ka dërguar juve rendi i ditës, nuk ka pasur reshje,

breshër e stuhi por gjithsesi si ta vlerësoni si pikë e veçantë e rendit të ditës apo si pikë në të ndryshme, pasi të flasim për pandeminë në vazhdën e saj me futë në pikën e katërt informatë rrëth zhvillimeve pra reshjeve të ditëve të fundit pastaj pika e peste identifikim i çështjeve problematike ose e lëmë të ndryshme.

Unë po e vë në votim rendin e ditës me theks të veçantë me bisedua pastaj edhe atë që e propozoi Fadili. Pra, ne mund të konstatojmë se aprovohet rendi i ditës pa asnjë votë kundër dhe asnjë abstenim, duke përfshirë edhe një informatë rrëth gjendjes momentale pra dëmeve si pasojë e reshjeve intensive të shiut dhe breshrit në këto 2-3 ditët e fundit.

### **1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

Ka dikush të shtojë diçka sa i përket procesverbalit nga mbledhja e kaluar, nëse jo e vë në votim: Konstatoj se në mënyrë unanime është aprovuar procesverbalit nga mbledhja e kaluar. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

### **2. Vlerësimi i përgjithshëm i gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit.**

Gjendja e përgjithshme e sigurisë në komunën e Rahovecit është e qetë stabile dhe ka pasur një mori veprimesh të cilat sigurisht megjithatë kanë ndikuar të ruajnë stabilitetin e përgjithshëm edhe në pikëpamje të sigurisë por edhe në pikëpamje tjera, edhe të konklaza se gjendja është stabile besoj që jemi dakord të gjithë. Ne i kemi pasur disa veprime të cilat i ka bërë edhe komuna e Rahovecit me njësitet e veta me sektorët e vet poashtu edhe policia e Kosovës por ka pasur edhe veprime të cilat kanë qenë të ndërthura ose të ndërlidhura me qëndrime ose angazhime edhe me institucione qendrore të Republikës se Kosovës. Po ashtu te shqyrtimi i dukurive negative, angazhimet tona masat veprimet qoftë të Komunës apo të Policisë me siguri që do të kemi rast me bisedua. Te trajtimi i objekteve jo të sigurta në komunën e Rahovecit, ne kemi tash një kontratë edhe për rrënimin e objekteve që janë uzurpime apo edhe rrënimin e objekteve të cilat nuk kanë siguri, në bashkëpunim me inspektoratin e Komunës e asistencën e Policisë, besoj që do të ekzekutojmë edhe veprimet që do ta rritin sigurinë e objekteve. Ne kemi ndërmarrë një veprim para se të shfaqet pandemia që duke e konsideruar të arsyeshëm vendimin që kemi marrë bashke edhe rekomandimet e veçanta që i kemi marr nga KKSBB-ja para shfaqjes se pandemisë, në kemi urdhëruar ose shkurtimin e orari të punës që kanë pasur lokalet e ashtuquajtura lokalet e natës pra e kemi zbatua vendimin edhe rekomandimin e KKSBB-se edhe të Policisë së Kosovës, pra kam nxjerrë urdhëresë për shkurtimin e kohës së veprimit të lokaleve të cilat besoj që të gjithë i dimë, operimi i të cilave është në kundërshtim me fryshtën e zbatimit të parimeve të ligjeve të aplikueshme në Kosovë, kemi konsiderua se ka edhe probleme tjera shtesë të cilat nuk i bëjnë ndër edhe nuk i shërbejnë dobishëm komunës se Rahovecit e as qytetareve të komunës se Rahovecit. Edhe pas përfundimit të pandemisë vendimi do të mbetet në fuqi dhe besoj që Komuna jonë, së paku edhe nga kjo pikëpamje do të jetë me e sigurte në kuptimin e asaj që do të zgjedhohet ose do të minimizohet mundësia e kriminalitetit ose veprimeve tjera që janë në kundërshtim me ligjin. Sa i takon monitorimit dhe raportimit mbi nivelin e sigurisë nëpër shkolla, e thash edhe më herët pasi nuk kemi edhe shumë se çka të bisedojmë përvèç nëse Drejtori i Arsimit ka diçka apo Policia ka diçka pasi ka më shumë se dy muaj që mësimi është ndërpërre dhe nuk ka aktivitete publike në objektet tona shkollore në asnjë nivele, as parashkollarë, çerdhe apo në mësimin e mesëm. Për luftimin e shkelësve të ligjit apo parandalimin ka se çfarë na fletë edhe komandanti i Policisë po ashtu edhe drejtori i inspektoratit komunal por e di që ka një përpjekje sistematike për me krye krejt çka është e mundur në kapacitetet tona dhe me pas sa me pak veprime të kundërligjshme ose veprime kriminale qofshin individuale apo të organizuara. Dhe po ashtu për parandalimin zjarrit ose përgatitjet për parandalimin e zjarrit ose përgatitjet për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve për parandalimin e zjarrit gjate sezonit veror, do të flet drejtori për mbrojtje dhe shpëtim Hasan Përboqi. Pra ne kemi se çfarë të flasim por në parim dua të them se gjendja e sigurisë në Komunën e Rahovecit vazhdon të jetë e qetë stabile dhe sipas bindjes tonë informatave që ne i disponojmë është edhe e qëndrueshme. Faleminderit shumë, e hapi diskutimin për të dhënë detaje tjera ose per të bërë njoftime komente tjera të cilat janë me rëndësi për pikën e dytë të rendit të ditës për sa i takon gjendjes së sigurisë në territorin e komunës së Rahovecit.

**Komandanti – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit në sallë.** Unë sot nuk do të ndalem të flas për të gjitha pikat por do të mundohem të jem ma i shkurtër gjate gjithë aktiviteteve që kanë ndodhur gjate këtyre dy muajve nga situata e pandemisë. Gjate kësaj periudhe mars, prill, maj sa jemi tani, në stacionin tonë janë regjistruar gjithsej 86 raste në total, 76 vepra penale dhe 10 incidente të ndryshme. Rastet e regjistruara me të renda gjatë kësaj periudhe kanë qenë një lëndim i rënde trupor, 3 lëndime të lehta trupore, 3 vjedhje pastaj raste dhe vjedhje e rënde kanë qenë gjithsej 6, edhe pse kemi menduar se do të ketë më shumë por ja është përfatim e mirë nuk ka pasur raste të vjedhjeve asistime në total në të gjitha institucionet kanë qenë 22 dhe 5 aksidente trafiku. Për nivelin e sigurisë neper shkolla nuk kemi çfarë të flasim pasi gjate kësaj periudhe ato kanë qenë të mbyllura mirëpo nëse ka dikush diçka me pyet apo me shtua. Gjate kësaj kohe të pandemisë me gjithë angazhimin që kemi pasur edhe kemi akoma ashtu siç e thatë edhe ju, situata ka qenë e qetë dhe stabile, edhe tani përmomentin e shtë sipas vlerësimit tonë dhe shpresoj se do të jetë kështu deri në përfundim edhe do të jetë e qëndrueshme edhe më tutje. Aktivitete ka pasur mjaft rrëth veprimeve, zbatimeve të veprimeve të ndryshme me ndryshim të përditshëm njëra pas tjetrës, mirëpo fal angazhimit edhe tonin edhe institucioneve tjera kemi arritur të i përballojmë dhe të i zbatojmë ashtu siç e shtë kërkuar. Gjithsej raste përmosveprim sipas dispozitive shëndetësore gjate epidemisë kanë qenë 25 pra janë iniciuar 25 raste, persona të arrestuar 55 ku prej tyre 32 janë ndaluar në mbajtje për 48 orë edhe 23 të tjerë kanë shkuar në procedurë të rregullt, kështu që bazuar në gjithë këtë apo gjithë në këtë kohë që kalojë, shpresojmë edhe ashtu e shtë se e kemi një situatë të qetë edhe stabile edhe shpresojmë se do të vazhdojmë edhe me tutje, të gjithë e dimë se e shtë një angazhim shume i madhe dhe ne akoma jemi me orar të rregullt zyrtar 12 ore edhe mund të them lirisht se nuk e shtë 12 ore por 24 orë pasi kohe po ndryshojnë rrëthanat dhe jemi duke vazhduar njëjtë deri sa pësojnë ndryshime tjera pasi ka qenë një punë e madhe dhe angazhim i madh mirëpo falë bashkëpunimit të mirë edhe me ju dhe gjithë të tjerët kemi arritur deri këtu në mënyrën ma të mirë të mundshme pavarësisht momenteve të ndryshme që ka pasur mosmarrëveshje apo keqkuptime mirëpo vlerësimi jonë e shtë se edhe ka qenë mirë por edhe mirë e shtë edhe pse kohen e fundit Rahoveci u bë pak më i alarmuar me rastet pasi edhe mua me detyruan, me shkua në pushim të dhunshëm. Unë nuk dua të marr kohë me shumë, kjo ishte në pikë të shkurta por nëse ka dikush diçka atëherë ne jemi këtu edhe do të mundohemi të ju përgjigjemi aq sa mundem. Faleminderit!

**Fadil Sylka –** Unë kisha një pyetje për Kapitenin, se a ka rritje gjatë kohës së pandemisë dhuna në familje a keni ndonjë informatë rrëth kësaj.

**Komandanti –** E shtë vërtet se ka pasur raste të dhunës ne familje edhe sigurisht se do të ketë por rastet që kanë ndodhur të ne absolutisht nuk i përkasin kësaj kohe që jemi edhe që kanë të bëjnë me pandeminë pra janë raste shume të rregulla dhe normale që ndodhin çdo ditë dhe do të ndodhin prapë mirëpo nuk ka asnjë arsy e shqetësim që për shkak të kësaj situate kemi pasur raste dhune ne familje. Por sido qoftë në krahasim sipas statistikave edhe pse njerëzit kanë pasur telashe dhe të ngjujar edhe mosmarrëveshje apo mospajtme janë prezantë pasi kemi çdo kush nëpër shtëpi tona, kështu që numri ka qenë shume më i vogël se para pandemisë, rastet janë shume me pak se përparrë.

**Bujar Morina –** Përshëndetje për ju kryetar dhe gjithë të pranishmit në këtë takim. Unë si anëtar i Këshillit për Siguri në Bashkësi pasi nuk e dëgjoja kapitenin e Policisë duke raportuar përrastin që ka ndodhur me datën 12 Prill ku janë shkatërruar varrezat e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas, që unë si anëtar i Këshillit për Siguri në Bashkësi i dënoj ashpër dhe besoj se njerëzit e pandërgjegjshëm i kanë shkatërruar varrezat dhe kanë dashur me ja prishë imazhin e keq komunës tonë por përsëri e falënderoj kapitenin e Policisë i cili ka qenë ne gjendje gatishmërie me shokët e tij dhe po ashtu të falënderoj ty kryetar që keni pritur deputetet nga radhët e këtyre komuniteteve dhe kam një pyetje për ju, se a e shtë kompensuar ashtu siç keni raportuar për dëmet e këtij rasti. Faleminderit!

**Komandanti –** Faleminderit Bujar, me vjen keq paraprakisht sepse e kam të evidentuar rastin por nuk e ceka sepse qysh ne fillim e thash se nuk do të lëshohem në detaje kështu me keqardhje po e them, rasti që të ne e shtë cilësuar sipas veprës e shtë ligjore dëmtimi i varrezave apo kufomave e shtë një rast gjithsej, që mund të them lirisht se qysh në raportim stacioni e shtë marr në mënyrën me serioze të mundur pasi nuk e shtë me rendësi se i kujt janë ato varreza pasi për të gjithë janë të barabartë dhe

ashtu duhet të trajtohen dhe është e dhimbshme dhe ne kemi bërë me të mirën e mundshme që u deshtë me bo, ka qenë një angazhim mjaft i madhe dhe janë intervistuar bukur shume persona, rasti akoma është ne hetime dhe po ashtu pjesa tjetër e komunës ka pasur një angazhim të madh edhe është bërë një vlerësim i të gjitha atyre, që besoj dhe shpresoj se do ta kemi një rezultat në zbulimin e kryesve ndërsa për anën tjetër i përket komunës dhe kryetarit të komunës. Faleminderit!

**Kryetari** – Ne natyrish se jemi distancuar menjëherë pasi ka qenë rast përvëç i pakuptimtë dhe i panevojshëm po ashtu edhe i papranueshëm. Kemi shkuar 2-3 herë në vend të ngjarjes qoftë ne si ekip i komunës me policinë, qoftë edhe bashkë me deputetët e Kuvendit të Kosovës që kanë përkatësi etnike rom, ashkali dhe egjiptas kemi shkuar po ashtu ju kemi drejtuar me një kërkese specifisht Ministrisë për Kthim dhe Komunitete, shpresojmë që ata do të na dalin në ndihmë dhe bashkë do ti rikuperojmë ose do i riparojmë dëmet e shkaktuara edhe besoj që policia e Kosovës gjegjësisht organet profesionale të shtetit tonë. Dëshira jonë me zbardh sa me shpejt që është e mundur edhe ata që i kryejnë këto punë kushdo qofshin pasi motivet nuk i dimë janë apo jo të paqëllimshme, duhet me marr dënimin e merituar dhe nuk është në traditën e popullit tonë se paku të shqiptareve që të merren me te vdekurit sepse është një ndër që tradicionalisht është respektuar edhe në ditët me të vështira pra vërtet kanë qenë ditë të vështira nuk i ka ngacmuar, nuk i ka prek, nuk ka shkatërruar asnijëherë së paku në mënyrë të vetëdijshme ose të organizuar dikush nga populli ynë, ndoshta ka pasur sponsorizime nga të tjerët për me arrit ndonjë kauzë të caktuar në të kaluarën por kjo ndoshta është më pak e rëndësishme sot por e rëndësishme është se ne e kemi kryer punën tonë dhe vazhdojmë të interesohemi me ngulm që kush janë ata që kanë bërë një veprim të tillë, që ndoshta edhe mund të mos jenë të shkaktuar nga njerëzit, që mund të jenë edhe bagëti kushtimisht po e them pasi një gjë të tillë nuk e dimë por unë edhe në emër tuajin kërkoj që të zbardhet kjo situatë dhe ne do ti riparojmë varrezat në momentin kur të kemi një kontratë qoftë ne si komunë, pasi ne jemi marrë vesh edhe me Ministrinë që në momentin kur të kemi ndonjë operator që merret me trajtimin e varrezave pasi kemi një kod që do ti rregullojmë të gjitha varrezat sidomos këto përmendoret pastaj varrezat e martirëve, dëshmoriëve kudo që i kemi, ata na i derdhin mjetet neve edhe për riparimin e varrezave të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptasve. Mos të harrojmë asnjëherë se aty është edhe një pllakë dëmtuar e një qytetari të komunitetit me përkatësi shqiptare edhe atij ju ka dëmtuar edhe e di me emër dhe nuk dëshiroj me i dhanë kurrfarë ngjyrimi apo konotacioni, vetëm se e di që në traditën tonë si popull që jemi me shumicë absolute këtu ne komunën e Rahovecit dhe në Kosovë nuk e kemi as për ndër apo traditë e as në kodet tona, të drejtë zakonore apo të trashëgimisë nuk ka ndodhur që dikush prej shqiptareve me i dëmtuar. Por sidoqoftë ne për derisa nuk kemi informatë zyrtare, nuk kemi zbardhje të rastit atëherë ndoshta edhe nuk është mirë me komentua me shume. E drejtë është ajo çka tha Bujari, faleminderit për mirëkuptimin tuaj!

**Ramë Berisha** – Unë desha të flas për gatishmérinë e stafit në krye me kryetarin që është prezent para nesh, po ashtu edhe gatishmérinë e Policisë për këto raste të prekshme të veçanta. Vërtetë në dhjetë ditshin e parë të prillit janë bërë disa sjellje prej njerëzve jo të shëndoshë mentalisht në ato varreza mirëpo menjëherë kryetari me stafin e vet ka qenë në gatishmëri edhe mjaft i përkushtuar, ne ditën kur na ka pranuar aktivistet nga Peja, Gjakova dhe kemi shkuar ne varreza atje dhe i kemi vizituar. Ajo është një arë e mirë për të tjerët që jemi në këtë jetë prandaj për këto raste është duke shkuar puna mirë që jemi në gatishmëri dhe këto munden me pas efektin e tyre para ndikimit të veprave që bëhen por edhe për autorët që i bëjnë këto veprime duhet me marr masa edhe me i qitë para drejtësisë, pa marr parasysh se aktorët e këtij rasti a janë nga rrëthi familjar apo rrëthit miqësor me u përgjigj për veprën e shkaktuar sepse ato shkojnë në dëmin e përgjithshëm shoqëror. Pra këto janë vepra të planifikuara e jo të rasteve p.sh. të fatkeqësive por është bërë me qellim me gjunjëzua popullatën e Republikës së Kosovës edhe me njollosë me këto veprime. Por me këtë rast që është bërë por edhe para 7-8 viteve ka pasur rast të tillë në një fshat të Hasit, njerëzit e tillë nuk munden me marr hak përmes veprave në këto vende qoftë në kulte fetare, qoftë në monumente historike, qofte neper varreza por unë mund të i quaj ata edhe qyqarë. Faleminderit

**Kryetari –** Qëndrimet tona janë të qarta sa i përket këtij veprimi apo këtyre akteve dhe faleminderit për kontributin që po e jepni, a dëshiron edhe dikush të inkudrohet sa i përket pikës se dytë të rendit të ditës. Atëherë meqë jemi në fund të pikës se dytë të rendit të ditës siç u tha edhe ne fillim, besoj që jemi dakord të gjithë se duhet të vazhdojmë të mirëmbajmë gjendjen e përgjithshme të sigurisë që e kemi të mirë, të qetë, stabile dhe të qëndrueshme. Pra duhet të forcohen angazhimet tona të të gjithëve institucioneve edhe të Policisë edhe të inspektoratit komunal edhe të anëtarëve të KKSBS-së edhe të ekipit që unë e drejtoj të Komunës, ne mënyrë që ta mirëmbajmë por të kemi edhe stabilitet edhe më të fortë dhe ta forcojmë edhe me tutje edhe klimën por edhe gjendjen e sigurisë se përgjithshme në Komunën e Rahovecit. Kemi pasur raste siç e përmendi edhe komandanti i Policisë, ne kemi edhe evidencë të plotë edhe për atë që ka ndodhur, pasi ju e dini se çdo 24 ore e kemi edhe raportin e Policisë, ka edhe raste që ndoshta edhe mund të mos përmendën këtu, por ne i kemi të gjitha informacionet e nevojshme për sa i takon kapacitetave që ka përgjegjësi pushteti lokal, instrumenteve që i ka dhe asgjë nuk është befasi, pra befasi mund të jenë vetëm fatkeqësítë elementare apo fatkeqësítë natyrore që edhe nuk mundemi të i dimë por për të tjerat edhe policia edhe ne, në kuadër të përgjegjësive tona besoj që jemi mirë të informuar edhe gjendjen e kemi nën kontroll dhe pavarësisht se jo gjithçka përmendët edhe flitet këtu. Ne kemi edhe plot çështje që mundemi ti debatojmë në nivele tjera në rrethe ma të ngushtë, në komunikim dhe ndërveprim ndërmjet institucioneve, policisë, komunës e organeve tjera por sidoqoftë besoj që rritja e stabilitetit është detyrë e përhershme e çdo ditshmë e institucioneve tona të komunës, e policisë, e anëtarëve të KKSBS-së dhe çdo mekanizmi që përfaqëson vlera apo ka për detyrë me ndërmarrë veprime dhe masa në funksion të forcimit dhe sigurisë se përgjithshme më territorin e komunës se Rahovecit.

Pra tani është drejtori Hasan Përboqi që mundet me fol diçka rreth zjarreve dhe përgatitjeve për sezonin veror për sa i takon detyrave që i ka Mbrojtja Shpëtimi dhe Zjarrfikësit në Komunën e Rahovecit.

**Hasan Përboqi –** Përshëndetje kryetar, nënkyetar, të nderuar anëtarë të Këshillit për Siguri në Bashkësi. Atëherë më lejoni që në emër të Drejtorisë për mbrojtje për shpëtim të paraqes një raport të shkurtër lidhje me intervenimet të njësisë për zjarrfikje dhe shpëtim në komunën e Rahovecit për periudhën raportuese 1 janar – 30 prill 2020. Për këtë periudhe raportuese njësia e zjarrfikësve ka pranuar thirje për ndihmë apo intervenim i ka pasur ne 79 raste, prej tyre i kemi të shpërndarë 17 raste në muajin janar, 17 raste ne muajin shkurt, 17 raste në muajin mars dhe 23 raste në muajin prill. Rastet janë nga me te ndryshmet duke përfshirë ne intervenime në zjarre fushore, intervenime ne zjarre malore, në shtëpi, ne aksidente, ne pastrime në vendngjarje pas aksidenteve dhe raste të tjera të ndryshme. Por fatmirësisht në të gjitha këto raste, pasi që kemi pasur intervenime nuk ka pasur viktima në njërs apo edhe të lënduar, ka pasur vetëm disa dëme materiale edhe pse kemi pasur disa raste të intervenimeve pak me serioze. Atëherë kjo ishte periudha raportuese janar- prill, atëherë ne si drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim në planin e punës për vitin 2020 e kemi paraparë që ne fillim të muajit qershor, për shkak se po hyjmë edhe ne sezonin e nxeh të vitit, të shpërndajmë thirje njëkohësisht edhe forma e thirjes që shpërndahet nga drejtoria edhe kjo është një formë e informimit se si të mbrohen qytetarët në rast objekti ku ata banojnë apo ndonjë hapësirë tjetër të përfshihet nga zjarri. Atëherë kjo thirje shpërndahet me nënshkrim të kryetarit, ku në këtë thirje janë të përfshirë të gjitha numrat që mund të kontaktohen zjarrfikëset nga çdo qytetar si dhe ky informim i përfshin saktësisht se si duhet mbrojtur qytetaret por edhe se si ata mund ta parandalojnë një zjarr të vogël që shkaktohet deri sa të vijë njësia e zjarrfikëseve për intervenim. Atëherë kjo ishte në pika të shkurta, nëse ka dikush diçka, do të jemi këtu për të ju përgjigjur.

**Kryetari –** Faleminderit drejtor, besoj që mund të ju them se kapacitetet e njësisë së zjarrfikëseve në komunën e Rahovecit janë më të rritura pra ka më shumë pajisje, më shumë kamionë për fikjen e zjarreve, ka punëtorë më pak sepse disa kanë dalë në pension dhe nuk kemi të drejtë me rekrutimin e punonjësve të njësisë së zjarrfikësve pasi është kompetencë e Agjencionit për Menaxhimin e Emergjencave që është agjencion qeveritar në kuadër apo në kompetenca të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Pra kemi më pak zjarrfikës, më shumë pajisje më shumë mjete mbrojtëse për zjarrfikësit

dhe shpresoj që do ta përballojmë bashke edhe s'do të kemi nevojë me i thirr ekipet shtesë nga komunat tjera siç ishte rasti zjarret në territorin administrativ ku ndahen tri komunat Rahovec Malishevë Suharekë ku mbi 5 ditë njësia janë e zjarrfikëseve bashkë me sektorin e Pylltarisë dhe shumë punëtorë tjerë vullnetarë janë detyruar që mbi 5 ditë të intervenojnë natën e ditën me fik zjarre për shkak se dikujt i ka shkua mendja me bo skarë në mal dhe nga pakujdesia e vogël ndezja ka qenë e qëllimshme ndërsa në hargjojmë edhe të holla edhe rrrezikojmë edhe zjarrfikësit për veprime të papërgjegjshme ose sjellje të pakujdeshshme të individëve që nuk e kuptojnë se sa janë kërcënuar këto situata kur prodhohen ndoshta në mënyrë të vetëdiçshme nga faktori njeri. Po ashtu kemi pasur edhe një zjarr të madh në objektin afér stadiumit, dhe janë detyruar me ndërhy ose me ardh në ndihmë edhe njësitet nga Prizreni, Suhareka, Malisheva, Gjakova edhe mezi kemi arrit me shpëtuar. Besoj që njësitë tona kanë qenë aktive, kanë kryer punën e vet por vet konstruktiv dhe vendi ku ka qenë objekti nuk ka qenë e lehtë me u intervenua edhe kjo ka ndodhë në kohë të pandemisë. Pra të dyja edhe zjarret, djegia e sipërfaqeve të shumta pylltarë në 3 komuna pastaj edhe në komunën kah Panorci, Zatriqi kemi pasur zjarre dhe plot lokalitete të komunës së Rahovëcit, qoftë nga hamulloret apo veprimet e pakujdeshshme të qytetareve tanë. Pra nuk është se zjarrfikësit tanë nuk kanë pasur punë gjate kohës së pandemisë dhe kjo është për keqardhje për shkak se ka veprime që lidhen me këtë pikën e shkelësve, nuk po them zjarr vënie e organizuar por ka zjarr vënie për shkak të pakujdesisë që konsiderohet vepër penale apo zjarr vënie e qëllimshme. Faleminderit, atëherë kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

**3. Informatë rrreth menaxhimit të situatës se krijuar nga ana e Komunës se Rahovëcit.** – Ne kemi një informatë këtu që mund edhe ta shihni pasi prej këtij momenti informata bëhet edhe publike për shkak se ne kemi pasur një informatë që e kemi publikuar me herët por për shkak të ndryshimeve që ndodhin çdo ditë edhe në Komunën tonë edhe në Kosovë u deshtë me rifreskuar materialin dhe me përditësua edhe me zhvillime të reja me situata të reja prandaj nuk e kemi parë të arsyeshme ose nuk kemi pasur mundësi, kjo është deri para dy dite kur është bërë gati kjo informatë është rifreskuar me elemente të reja. Veç mundem me ju than se unë po dua me ju falënderua së pari qytetarët e komunës së Rahovëcit pa dallim, inspektoratin komunal, Policinë e Kosovës e posaçërisht gjithë stafin e Qendrës Kfyesore të Mjekësisë Familjare në Rahovec prej drejtorit QKMF-së e drejtorit të Shëndetësisë e deri te ai infermieri i fundit apo stafi teknik që kanë qenë këto institucionë bashkë me shtabin tonë komunal ku përfshihet komandanti i Policisë, Drejtori i Qendrës për Punë Sociale, përfaqësuesi i Kryqit të Kuq edhe shtabi i posaçëm emergjent siç e kemi cilësuar ne edhe e kemi themeluar qysh herët kanë bërë një punë bukur të madhe e cila ka pasur vetëm një qellim ndërmarrjen e veprimeve dhe masave të caktuara për parandalimin e përhapjes se sëmundjes ngjitëse siç po quhet Covid-19. Periudhën e parë ose pjesën e parë, pasi siç e dini ju nga 14 Marsi pasi kemi rastin e parë të infeksionit në Kosovë. Periudhën e parë e kemi kaluar shume mirë pasi nuk kemi pasur asnjë raste dhe në të njëjtën kohë kemi ndërmarr veprime shume serioze të cilat kanë qenë të dobishme dhe i kanë gjykuar dhe vlerësuar të dobishme edhe institucionet tjera. Kemi filluar me dezinfektimin e objekteve shëndetësore që të gjithave, kemi bërë dezinfektimin e objekteve publike si komuna, stacioni policor, stacioni i autobusëve po ashtu kemi vazhduar me dezinfektimin e xhamive në komunën e Rahovëcit, pastaj të teqeve në komunën e Rahovëcit, hapësirave të rëndësishme publike pastaj kemi vazhduar edhe me dezinfektimin edhe të objekteve të cilat nuk janë nën menaxhimin e komunës së Rahovëcit si objekti i gjykatave, qendrave regjistrimit civil që janë objekte të Ministrisë së Brendshme pastaj kemi bërë edhe dezinfektimin e objekteve të Ministrisë se Drejtësisë pra gjykaten pasi është objekt që menaxhohet nga Ministria e Drejtësisë. Pra nuk kemi pasur kohë me zgjedh se ku përfundojnë detyrat tona e ku fillojnë detyrat e institucioneve tjera por krejt çka ka pasur në komunën e Rahovëcit që kemi vlerësuar që mund të jetë me rrëzik në përhapjen e virusit Korona, ne jemi munduar edhe kemi krye pothuajse me punë vullnetare dhe pa shpenzime financiare. Kuvendi i komunës se Rahovëcit në këtë sallë ka vendosur për nevoja të pandemisë me ja nda dhe me ja dhanë mundësinë kryetarit të komunës dhe ekipit të tij 10,000 euro pra kaq kemi kërkuar, që deri me tanë këtë shumë të parave as që kemi nis me i shpenzuar zyrtarisht, pra nuk ka asnjë shpenzim deri me tanë për nevoja të pandemisë nga buxheti i Komunës së Rahovëcit. Por mos të harrojmë se nuk ka asnjë mbështetje

financiare nga niveli qendror për përballjen që e kemi të çdo ditshme si çdo komunë tjetër si gjithë Kosova edhe ne si komunë e Rahovecit.

Po e ritheksoj se nuk kemi shpenzuar mjete prandaj jam falënderues ndaj qytetareve fillimisht, pastaj ndaj donatoreve dhe donacioneve të shumta që ka pranuar komuna e Rahovecit gjatë fazës së pandemisë, prej atyre që janë biznese pastaj subjekte të caktuara ekonomike, njerëz të vullnetit të mirë që janë këtu në komunë apo që janë nga komuna jonë e që jetojnë dhe veprojnë në mërgatë e deri te bashkësitë fetare si Teqja e Madhe po ashtu edhe ndihma nga Bashkësia Islame, po ashtu kemi pasur ndihmë edhe nga Kryqi i Kuq pastaj donacione nga UNICEF-i pastaj edhe organizata tjera joqeveritare, biznesmenë të caktuar dhe mendoj që krejt këto ndihma na kanë mundësuar përvëç që të kemi në depon e krijuar posaçërisht për këtë qellim, kemi shpërndare një numër të madhe të pakove ushqimore, higjenikë dhe miellit për nevojat e familjeve që kishin probleme, për rastet skamnore pra rastet socialë që i ka komuna jonë. Nuk ka edhe një rast të vetëm që ka kërkuar ndihmën e komunës së Rahovecit me pako ushqimore, me pako higjenike me miell dhe produkte tjera që komuna e Rahovecit nuk i ka dalë ndihmë, e që kuptohet kjo ndihmë ka ardhur prej donatoreve e që është ndoshta nder komunat e rralla në Kosovë që ka pranuar kaq shume donacione në një periudhe të shkurtër dhe unë i falënderoj të gjithë që po ashtu edhe në emër tuajin publikisht dhe në situatë më të mirë në rastin e parë do të ju vërtetoj këtë duke ju dhënë edhe në emër të qytetareve edhe në emër tuajin edhe mirënjohje për shkak se këto ndihma të tyre kanë ndikuar që ta kemi edhe një stabilitet edhe në kuptimin e sigurisë kështu që e kemi mbajtur stabilitetin falë donatoreve. Shpenzimet e buxhetit kanë qenë pothuajse zero, unë i falënderoj edhe ata që na kanë ndihmuar edhe me material dezinfektues që është një sasi e madhe sepse dhjetë herë janë dezinfektuar objektet shëndetësore deri në këtë moment që po flasim që nuk e kemi vetëm objektin në Rahovec por i kemi disa objekte shëndetësore të shtrira në komunën e Rahovecit, pastaj rrugët dhe rrugicat janë dezinfektuar nga 3 herë, po ashtu kemi pasur edhe ekipet vullnetare që na kanë dalë në ndihmë për dezinfektimin jo vetëm të rrugëve kryesore por edhe të rrugicave nëpër vendbanime që kanë pasur mundësi me depërtua pra edhe ekipet vullnetare edhe Ekoregioni Ekodrinia janë dezinfektuar rrugët kryesore disa herë. Po ashtu objektet komunale mirëpo një periudhën e dytë është mirë me ditë edhe ju pasi atë që e kam thënë në televizion do të jem në gjendje me ju përmbytje para çdo kujt, qoftë edhe para prokurorit gjykatës dhe gjithkujt se virusi është eksportuar nga reparti i hemodializes në Prizren, fillimisht me dy punëtorët shëndetësorë të infektuara në vendin e tyre të punës dhe më pastaj me 4 pacientë të cilët marrin shërbimet e tyre në atë repart që është fat i mirë për gjithë këtë gjendje që nga 37 pacientë sa ka komuna e Rahovecit e që marrin shërbime të rregullta në repartin e hemodializes në Prizren, prej tyre vetëm 4 kanë marr infeksion që fatkeqësisht 2 prej tyre nuk kanë mundur me jetua pasi kanë qenë me Covid-19 pra i kemi dy raste të vdekjes që i kam ngushëlluar dhe në emër të qytetarëve të Rahovecit që njeri ishte 77 vjeçar kurse tjetra ishte 65 vjeçare, që kanë pasur edhe komplikime te tjera shëndetësore dhe në Klinikën Infektive kanë ndërruar jetë. Tash i kemi 35 raste në fazën e dytë pas eksportimit në repartin e hemodializes në Prizren, rastet e para sigurisht janë hulumtuar gjurmët e kontaktit dhe kemi rastet e kontakteve familjare me punëtorët shëndetësorë pastaj gjurmët e kontakteve dhe gjithë kjo ka rezultuar me këto shifra, kuptohet ata që kanë qenë me Covid që të gjithë janë karantinuar, familjet e tyre gjithashtu që po besoj që i kanë respektuar rregullat që kanë qenë burim nga kjo gjendje dhe tash gjithsej kemi 35 raste me infeksion Covid-19, prej tyre 19 i kemi aktive pra kanë virusin apo nuk është vërtetua që janë shëruar nga virusi, ku 15 i kemi të shëruar, e kemi pasur një frikë të jashtëzakonshme të përgjegjësisë kuptohet, të gjithë pacientët e hemodializes janë testuar dhe ritestuar dhe fatbardhësisht vetëm 4 kanë dalë pozitivë kurse të tjerët kanë dalë negativ, ku mbrëmë e kemi pasur testin e fundit dhe jemi frikësuar nga një paciente që mos po na përhap virusin në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe fatbardhësisht 7 testet kanë dalë negative dhe ata janë tanë në vetizolim sepse duhet me ju përmbytje rregullave dhe rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik dhe çdo rasti me Covid-19 ju ka shkuar pakoja ushqimore, pakoja higjenike dhe është bërë dezinfektimi i mjedisit ku jeton, edhe ka marr përsipër komuna e Rahovecit edhe të gjitha shpenzimet sa i takon ilaqet, barnave ju ka plotësuar që në kushte normale mirëpo ne i kemi marr përsipër. Gjendja shëndetësorë e pacienteve

që aktualisht janë me Covid-19 është stabile dhe nuk kanë simptoma serioze që do të ndikonin në përkeqësimin e gjendjes, pasi kam informatat që deri më tanë kemi stabilitet edhe shpresojmë që mos të kemi raste të reja me Covid-19 edhe pse nuk mundemi ta dimë tash se çka mund të ndodhë pas 2-3 dite, për shkak se ju e dini se vijnë edhe nga mërgata në Aeroportin e Prishtinës dhe futen në karantinë, po ashtu qarkullimi i njerëzve që munden me ardh prej Prishtine Ferizaj sikurse edhe ne që mundemi me shkua ne këto qytete. Pra gjithsesi ne kemi kërkuar dhe vazhdojmë të kërkojmë zbatimin ose përfilljen e rekomandimeve nga ana e IKSHP-së dhe masat e Ministrisë se Shëndetësisë. Kemi në fazën e dytë nga data 4 maj kur ka filluar zbutja e masave, e keni parë që janë rritë dinamikat aktivitetet dhe janë rikthyë disa veprimtari, ka lëvizje më të shumta të qytetarëve dhe ne vazhdimisht apelojmë dhe bëjmë thirrje te qytetarët të bëjnë kujdes, vizitat familjare, vizitat në grupe janë evidente dhe ne kemi porositur ose kemi kërkuar nga Policia dhe Inspektorati që të janë të vëmendshëm. Pra qëllimi jonë nuk është me i dënuar askënd por kërkesa jonë e përditishme është që aty ku ka grupe të qytetarëve të shpërndahen dhe aty ku ka lëvizje të parregullta të ndalen por mundësish sa më pak të dënohen njerëzit sepse ashtu janë duke vuajtur humbjet dhe pasojat e pandemisë e cila ka filluar prej 14 marsit e deri në këto komente. Nuk siguroj që ka me vazhdua dhe me tutje për kundër faktit që shpresojmë që do të zbuten masat edhe do të kemi një hapje më të madhe edhe sa i takon veprimtarive të shumta të cilat janë evidente në këtë periudhë pandemike. Ne jemi duke u përgatitur me incizua gjendjen edhe në thellësi edhe në gjerësi se cilat janë humbjet e komunës së Rahovecit, qytetarëve të komunës së Rahovecit në ekonomi, biznese, bujqësi tregti në çdo sferë se cilat janë humbjet dhe do të bëhet një raport profesional i detajizuar mirë dhe ky raport do ti shkojë patjetër Qeverisë së Kosovës për ti përfshirë sa më shumë që është e mundur në pakon e rimëkëmbjes ekonomike e pse jo edhe në pakon emergjente kategoritë që kanë humbur shumë edhe vazhdojnë të humbin edhe sot. Vetëm një përllogaritje e thjeshtë e kësaj periudhe pandemike, vetëm te bizneset është mbi 2,600,000 euro në Komunën tonë, pa hy në detaje të mëtutjeshme por ne shpresojmë që të kemi raportet për pasojat dhe humbjet në periudhën pandemike e që Qeveria e Kosovës besoj që ka për obligim me i adresua si edhe në komunat tjera edhe në komunën tonë në pakon mbështetëse finançiare e që është emergjente e posaçërisht në pakon e rimëkëmbjes ekonomike që është detyre e secilit institucion që ta reflektoj në këtë gjendje pandemike që jemi. Ne kemi zgjatur orarin e punës dhe orarin e dhënieve se shërbimeve nga ana e qendrës kryesore të mjekësisë familjare, po ashtu kemi pasur një komunikim të mirë me institucionet relevante që merren me çështje profesionale për sa i takon përballjes me më efikasitet me pandeminë Covid-19. Ne kemi pasur një komunikim edhe me Institutin e Shëndetësisë Publike në Prizren dhe në Gjakovë po ashtu edhe në Prishtinë dhe besoj që informacionet e nevojshme sa i takon qytetarëve të komunës së Rahovecit që janë marr mostrat dhe që janë testuar apo ritestuar na i kanë dhënë me kohë dhe afat rekord dhe ne kemi pasur informacione ende pa dalur lista zyrtare dhe ka dalë me komunikatën e vet kryetarit të komunës i ka ardh lista, dhe ne kemi pasur informacion të plotë se çka po ndodhë dhe kemi edhe sot. Gjate periudhës së pandemisë, ne e kemi reduktuar stafin e punonjësve të shërbimit civil, në përgjithësi sipas një rregullative që ka ndodhur në komunat tjera dhe unë ju them që bashkë me ekipin tim e posaçërisht me drejtoret e drejtoreve edhe me stafin udhëheqës po ashtu edhe një pjesë e punonjësve që kanë bërë njëfarë orari nuk jemi ndalë për asnjë moment për me mbërritësa kemi mundësi dhe fuqi ndikuese përplot masa dhe veprime që nuk janë të gjitha në këtë raport dhe kemi mbërritës deri këtu. Sigurisht që unë jam falenderues ndaj stafit të shërbimit civil që asnjëherë nuk i ka ndalë shërbimet jo vetëm këtu por as në gjeodezi, financa, kadastër, urbanizëm e as në inspektorat sepse këta kanë qenë në vijën e parë të terezikut bashkë me mjeket infermieret, teknikët, me punëtorët shëndetësor po ashtu edhe me policinë por nuk janë ndërprerë për asnjë minutë shërbimet që madje ka raste që është punuar edhe ditën e shtunë edhe të dielën nëse ka pasur nevojë për shërbime sidomos kur filloj me u kufizuar liria e lëvizjes së qytetarëve nga ana e Qeverisë së Kosovës e posaçërisht Ministrisë së Shëndetësisë dhe ne jemi detyruar me dhanë leje ose pëlgjime për subjekte të caktuara qofshin ato ekonomike pastaj për individë të caktuar që kanë pasur raste dhe situata të ndryshme që ne u deshtë me dhanë një protokoll për me lëvizë me shkua në spital apo për raste tjera urgjente dhe nevojave të caktuara dhe asnjë minutë nuk ka pushuar puna në komunën e Rahovecit dhe

nuk e di çka nuk kemi bërë dhe që nuk na ka thënë dikush mirë është me bo edhe që kemi refuzua me bo. Pra për here të parë jemi ballafaquar me këtë situatë pasi jemi kon edhe në luftë dhe një situatë e tillë vërtete ishte e vështirë dhe e paimagjinueshme pasi kishte raste të tilla që vërtet nuk mund të shpjegohen pasi katër qytetarë shkojnë me një makinë në hemodialize dhe dy dalin pozitiv dhe dy negativ, unë qysh në fillim kam dyshuar e që po dyshoj edhe tanë sidoqoftë kjo nuk është nisur këtu te ne por në Kinë që na ka përfshije edhe neve por e rëndësishme që shëndeti i qytetarëve dhe jetë e qytetareve se paku deri në këtë minutë që po flasim nuk është rrezikua nga Covid-19. Nuk do të thotë që nuk duhet të kemi kujdes për këtë dhe sillemi pa kujdes të shtuar dhe të lejojmë grupe qytetaresh të bëjnë veprime dhe lëvizje të pakujdeshme por në masat parandaluese dhe preventive që kemi për detyrë që të gjithë me i respektua dhe është mirë me i respektua që të gjithë për shkak se ekziston një rrezik se nëse ne nuk jemi të kujdeshëm atëherë mbetet një vatër epidemiologjike këtu në komunën tonë, të tjerët vazhdojnë punën dhe ne mbesim të fundit dhe pastaj edhe ndonjë rrezik tjetër që me duhet me luftua edhe me mjete rrethanore për mos me lejua me u vendos Rahoveci në karantinë. Nuk është që nuk kishte ide apo që nuk kishte kërkesa, vetëm paramandoni zonën më punëtore, pra qytetaret më punëtorë me i vendos në karantinë se çka bohet sidomos edhe tash pas breshrit e shiut të rrëmbyeshëm. Prandaj unë ju lus juve që bashkërisht ku kemi mundësi me ndikua edhe me ju thënë se paku që kurkush nuk po ju dënon dhe duhet të ju përbaheni rekomandimeve që i ka IKSHP-ja edhe kërkesave që në vazhdimësi i bëjmë edhe ne si shtab. Nëse kemi raste të reja ose përhapet virusi atëherë ne do të kemi probleme atëherë pandemia zgjat këtu te ne dhe të tjerët vazhdojnë punën dhe ne kufizohemi brenda kufijve tanë prandaj është mirë me pas kujdes që të gjithë nëpërmjet edhe këtij takimi edhe secili anëtarë i KKSBB-së aty ku ka fuqi ndikuese së paku do të ishte e arsyeshme me krye detyrën e vet dhe me ju thënë që me i respektua sa më shumë që është e mundur. Pra pak kemi dënimë, sigurisht që Policia i ka punët e veta dhe në shumë pak po veprojmë sepse edhe ashtu nëse dikush ka humbur 20 mijë euro edhe ti e dënon përsëri atëherë kjo veçse e rendon edhe më shumë gjendjen por sugjerimi dhe rekomandimi për me pas kujdes me të madhe vlen edhe sot nesër edhe këto ditë të Bajramit që i kemi para vetit, për shkak se nganjëherë duhet me bo shmangje nga tradita dhe trashëgimia për hir të respektit ndaj shëndetit ndaj qytetarëve, jetës së qytetareve edhe ndaj veprimeve që minden me i marr institucionet që kanë peshë më të madhe vendimmarrëse saqë neve nuk na pyesin hiq dhe na dalin probleme tjera. Këtu janë 14 raste mirëpo ne e kemi rastin në Retijë, të shëruar plotësisht, pra kur është bërë raporti nuk ka mundur me u rifresku, kemi testime dhe ritestime dhe kemi 15 raste të shëruara, kemi 19 raste aktive, që gjithsej 35 raste dhe prej tyre 2 qytetarë kanë vdekur. Ky është bilanci i deritanishëm deri më tanë me pandeminë në komunën e Rahovecit. Në këtë raport ju mund të shihni pastaj pas publikimit në web-faqe dhe mund të gjeni plotë aktivitete të cilat i ka ndërmarrë komuna e Rahovecit edhe në kuptimin e masave dhe veprimeve por edhe në kuptimin e komunikimit dhe furnizimeve që i kemi pranuar nga Ministria e Shëndetësisë qofstë me maska, dorëza po ashtu qofshin edhe veprime që i kanë ndërmarrë donatorët në mbështetje të komunës së Rahovecit qofshin edhe në listën e barnave esenciale kur i kemi marr furnizimet, sa janë sasitë etj. Gjendja momentale është stabile, kemi furnizime mjaftueshëm, lista e barnave esenciale është mirë tash e që nuk ka qenë mirë në fillim sepse në dhjetë ditët e para nuk kemi pasur as stafi i komunës e leje më të tjerët dhe ishte vërtet një gjendje e rend mirëpo e kemi përballua pa zhurmë mirëpo më vonë kanë filluar furnizimet me ardh pak më të rregullta dhe e kemi stabilizuar gjendjen, e që në stabilitet kanë ndikuar shume donatoret e që pa ndihmën e tyre do të ishim shumë më keq dhe pa donatorët do të ishim ballafaquar edhe me ndonjë protestë që policia e Kosovës vështirë do ta kishte me i shpërndarë pa i thirre ato njësitë elite. Gjatë kohës së pandemisë e kemi pasur edhe një situatë që duhet ta përmendi patjetër dhe ju e vlerësoni vetë pastaj, lidhur me tregun sepse ka edhe zëra pasi është edhe demokraci dhe le te mendojnë njerëzit secili sipas mënyrës se vet, që sigurisht edhe unë si kryetar komune se bashku me ekipin tim e kryej detyrën time në kuadër të përgjegjësive që më takojnë. Unë jap llogari qytetarëve të komunës së Rahovecit. E gjithë puna ime dhe ekipit tim bazohet në ligjin e vetëqeverisjes lokale dhe ligjet e aplikueshme në fuqi. Kërkesën për treg pra për hapjen e tregut në Rahovec paralelisht e kemi bërë me kërkesën që fermerët dhe bujqit e komunës së Rahovecit të kenë

qasje dhe të kenë mundësi me shkua me i punua tokat e veta, vreshtat dhe me i realizuar të mbjellurat e të tjera. Këtë kërkesë në mënyrë permanente edhe fizikisht ja kam thënë z, Sfeqla, z. Kurti, z. Vitja, znj. Emilia Rexhepi edhe këtu kur na kanë vizituar në Komunë por edhe ne takime tjera. Ka ardhë koha kur presioni i fermerëve për prodhimet e gatshme është duke u rritur sepse ne fillim nuk ka pasur edhe shumë, vetëm ata që kanë punuar nëpër serra mirëpo tani ka filluar edhe shumë rritja e presionit të fermerëve, pasi kanë qenë dy rrugë ti lejojmë të hapim tregun aty ku kemi planifikuar dhe i kemi marr të gjitha masat ose me dal ne protesta edhe mos mos me pas kurrfarë përgjegjësie. Ne kemi pasur një numër të madh të njerëzve, me siguri mbi 100 i kemi pasur në Komunë dhe kam përshtypjen se ata nuk e dinë se qysh funksionon jeta nëpër komuna atje në Prishtinë dhe nuk e kuptojnë që në raste të tilla dhe nëse ti nuk e menaxhon apo administron atëherë gjendja bëhet alarmante dhe sigurisht që do ta kemi shumë të vështirë pastaj dhe kur ka ardh presioni duke u rritë, ne kemi filluar me komunikua edhe me shkresë dhe besoni që emrat që i përmenda me herët, që të gjithë kanë premtuar se do të jemi në rregull dhe këtu në komunën e Rahovecit me kanë thënë se ju jeni shefi këtu dhe kuptohet rekomandimet e IKSHP-së duhet me u respektua. Ne kemi bërë edhe plan operativ ku kemi pasur me i vendos 16 fermerë qysh në ditën e parë dhe sipas kërkesave me i bo me ndërrime, sigurisht që e dini që hapësira është te tregu i rrushit dhe e dini se kushtet ekzistojnë aty, uji, toaletet edhe mundësia për me menaxhua krejt hapësirë prej 1 hektar e 10 ari pasi nuk ka nevojë nga policia që të menaxhohet, për shkak se nuk kemi llogaritë që mundem me ardhë aty me mijë njerëz në atë treg por ai vend është rregulluar në atë mënyrë që një numër i vogël i fermerëve munden me ardh edhe nga vendet tjera si Prizreni apo Gjakova dhe sigurisht me pas vendin ku të shesin. Fermerët tanë kanë shitur në Prizren rregullisht po ashtu edhe në Fushë Kosovë, kanë shitur në Prishtinë dhe në Pejë mirëpo nuk kanë pasur të drejtë me shitë në Rahovec. Unë nuk i jap kurrfarë karakteri kësaj mirëpo vetëm e di dhe jam i sigurt që po flas të vërtetën dhe pa hile. Deri një javë e kemi pasur vendimin ne web-faqe pra prej të hënës e deri ditën e premte mirëpo dikur masdite të prenten kanë filluar të nxehen atje dikush në Prishtinë edhe pa e lajmëruar kryetarin e Komunës e që komuna e Rahovecit nuk është pa zotë të shtëpisë dhe unë jam kryetar i zgjedhur legal dhe sigurisht që besimin ma kanë dhënë qytetarët, vendimi bazohet në ligjin për vetëqeverisje lokale dhe duke i përfillur maksimalisht edhe masat e Ministrisë së Shëndetësisë edhe rekomandimet e IKSHP-së, pra në përputhje me respektimin gjendjes pandemike dhe dikur në mbrëmje kanë filluar që të mos e përfillin vendimin tonë dhe policia e ka krye punën e vet dhë gjë të cilën e respektoj shumë jo vetëm pse është uniforma jonë por e kanë krye punën e vet dhe janë vendos të tregu po ashtu janë ardh edhe njësia speciale sigurisht jo me u konfrontua me fermerët pasi jam detyrua me fol edhe me drejtorinë e përgjithshme të Policisë z. Rashit Qalaj që ja kam potencuar të gjitha se fermerët janë për të shitur produktet e tyre dhe jo me u konfrontua. Pra Policia e ka kryer punën e vet dhe unë jam krenar që kemi arrit me u marr vesh me ata edhe pse kanë qenë të urdhëruar me veprua ashtu. Nuk ishte dëshira jonë që kjo të bëhet temë diskutimi dhe ata që merren me bujqësi dhe ka edhe prej juve që merren me bujqësi, do të ishte mirë që të shkojnë edhe ti pyesin ata që i kanë gjuajtur fidanet, sallatet dhe që ska mundur me ju marr asnjëra nga kompanitë e mëdha si Viva, Etc-ja, Qtx-ja dhe i kanë hedhur prodhimet e tyre dhe përgjigja duhet te merret nga ata që kanë vendosur për këtë. Kur të vendos Kryetari i Komunës në një komunë të caktuar edhe kur i përfill krejt rregullat e lojës dhe madje vendos në një hapësirë kur vetëm 16 bujq pasi aq ishte kapaciteti i tezgave me distancë 6 metra atëherë përgjegjësinë e merr kryetari për këtë nëse eventualisht ishte përhap virusi dhe isha bërë shkaktar unë atëherë unë do të jepesha dorëheqje dhe isha përgjigjur penalisht sepse edhe me ligjin që është i aplikueshëm për përhapjen e sëmundjeve ngjiti të edhe me gjendjen emergjente të shëndetit publik ai që shkakton përhapjen e virusit atëherë ai bën vepër penale dhe përgjigjet edhe me gjobë edhe me burg. Pra deri sa kemi vendos ne në përputhje me këto rrethana atëherë e kisha marr përgjegjësinë pasi nuk jam prej atyre që ju ikim përgjegjësisë pasi nuk i kam ikur Serbisë. Mendoj se është padrejtësi e madhe që ju ka bërë Rahovecit dhe ata që kanë vendosur kështu do të përgjigjen në çdo situatë për dëmet të cilat i kanë përjetuar fermerët edhe në kohën e pandemisë edhe prodhimet e tyre të gatshme që nuk kanë pasur ku me i shitë. Kjo nuk është kurrfarë paralajmërimi por unë kam me kërkuar shpjegim deri në fund, në çdo situatë pse ndodhi mbyllja e tregut dhe çfarë borgji fermerët e

Rahovecit i kanë dikujt. Pse i lejon fermerët e Rahovecit me shkua ne Prishtinë, Fushë Kosovë, në Prizren me shitë e nuk i lejon në Rahovec dhe nëse dikush ka problem me Smajl Latifin dhe ju siguroj që nuk ka assesi pasi jam shumë i përgjegjshëm për veprimin tim dhe ju dal përballë pasi bujqit e Rahovecit nuk i kanë faj askujt madje bujqve të Rahovecit i ka borxh dikush dhe krejt çka mundemi me bo ne është se duhet me ju ndihmua dhe jo me i goditë edhe si komunë edhe si shtet, për këto ju kam thënë edhe Emilia Rexhepit edhe zyrtareve të tjerë, se dikush ka me pagua çmim për veprime arbitrale dhe masa të çuditshme që merrni ndaj fermerëve të Rahovecit, pasi ata mua nuk mundë asgjë me më bo por detyra ime është që me mandatin që ma kanë dhënë qytetaret edhe ligji të ngarkon me ju shërbyer qytetarëve të Rahovecit dhe unë e di që fermerët për mbi një javë janë goditë për shkak se nuk kanë pasur prodhimet e veta ku me i shitë kurse tash ne fazën e dytë hapet tregu mirëpo nuk kanë asgjë për të shitur sepse prodhimet e tyre janë dëmtuar aq shumë saqë nuk kanë asgjë për të shitur, pasi dëmtimet shkojnë deri në masën 100% Dhe tash tregu është i lejuar mirëpo bujqit e komunës së Rahovecit nuk kanë asgjë për të shitur dhe ne kemi lejuar dhe kemi detyruar fermerët me shitë rrugëve përgjatë aksit rrugor në fshatin Xërxe dhe Krushë pastaj në Ratkoc e Rahovec ndërsa dikush atje në Prishtinë ka vendosur me i ndalua këto, dhe këto vërtet janë veprime të çuditshme. Unë edhe njëherë e falënderoj Policinë e Kosovës dhe njësitet e veçanta që ishin atë ditë edhe pse nuk na ka pëlqyer ndalesa mirëpo e kemi përfill aksionin e policisë, unë kam mundur me bo shumë probleme kur ka qenë pandemia sepse nuk lejoj askënd të keqpërdor pozicionin tim pasi kur mbroj interesat e përgjithshme atëherë jam shumë i vendosur në përgjegjësinë time në raport me qytetarët por nuk kam dashur sepse pandemia ishte ajo që duhet të jemi të matur dhe të përgjegjshëm mirëpo për sa të jam kryetar i komunës nuk do të kalon kushdo që do të jetë në qeveri dhe i bën padrejtësi komunës së Rahovecit. Nuk mundet dikush me u sjellë me qytetarët tanë pa u konsultua me kryetarin e komunës dhe nuk duhet dikush me planifikua masa pa u konsultua me kryetarët e komunave, me Asociacionin e Komunave dhe nuk mundesh ti me një letër për 100-ditëshin me më falënderua si Kryeministër dhe si qeveri e ndërkohë që veprimet te cilat ndërmerrten nga Ministritë e caktuara e që janë në kundërshtim me normat me elementare njërezoje dhe institucionale. Ne kemi pasur reagim edhe si kryetarë të komunave me këshillin e kryetarëve të komunave dhe asnjë kryetar komune nuk është konsultua dhe ndërkohë kur shihesh në tavolinë se ju jeni në front dhe po e mbani vijën e zjarrit pastaj se pa juve nuk bëhet asgjë dhe kjo punë nuk është hajgare sepse po merremi me shëndetin publik dhe sigurisht edhe ne kemi mundur me qenë të infektuar të gjithë dhe duhet me shumë respekt institucional edhe pse instrumentet e pushtetit lokal janë më të pakta se sa instrumentet që i ka niveli qendror por ne kapacitetet e pushtetit lokal në çdo komunë janë në vijën e parë të frontit bashkë me policinë që e ka stacionin afér aty, bashkë me inspektoratin, mjekët, tekniket, motrat medicinale dhe krejt punëtorët e asaj komune janë në vijën e parë të zjarrit. Edhe në mënyrë të shkruar na kanë thënë se nuk munden me bërë asgjë mirëpo ndërkohë janë ndërmarrë veprime pa konsultim dhe komunikim dhe të gjitha ato masa që janë ndërmarrë, kushtetuta disa i ka cilësuar jo kushtetuese ndërsa për neve i kemi zbatuar sepse kemi për detyrë me i zbatua mirëpo janë shumë të çuditshme dhe arbitrale e jo të dobishme por ne i kemi zbatuar dhe vazhdojmë me i zbatua për shkak se kemi logjikën e veprimt institucional dhe përfaqësojmë interesat e qytetarëve. Për pandeminë mund te flas aq shumë, po ashtu edhe Fatmiri e gjithashtu edhe Samiri ndoshta edhe më shumë për shkak se ka mbajtë një barrë të madhe mirëpo për sot qak qisha dhe çdo gjë që ka paqartësi ne do të ju japim raport që mund ta shihni edhe fizikisht po ashtu do ta keni edhe webfaqe të Komunës se do të jet publik siç do të jen publike edhe plot tema tjera që lidhen me pandeminë.

**Nysret Abazibra –** Përshëndetje kryetar për ju dhe stafin tuaj dhe gjithë ju të pranishëm në sallë. Fillimi isht falënderoj për kontributin dhe angazhimin e palodhshëm që keni bërë deri me tash edhe me tutje që vazhdoni ta bëni. Normal shqetësimet e juaja janë edhe shqetësimet tona dhe problemet që po ballafaqohen në përditshmëri janë të gjithëve dhe duhet me nga brengos dhe ngritë ndërgjegjen që të ndërmarrim ajo qka është më e mira për vendin tonë. Unë do të ndërlidhem vetëm për rastet e fundit të paraqitjes se virusit Covid-19 dhe në një farë mënyre po e ngriti shqetësimin edhe frikën që të mos na ndodh ajo që paralajmëruat ju që mundet me na ndodhë, nëse nuk e menaxhojmë ashtu siç duhet.

Prandaj unë po e ngreh shqetësimin ne trajtimin e rastit të fundit sa është bërë profesional dhe sa është bërë sipas rregullave të gjurmimit, ngase po flas në atë aspekt, pasi që jam shume afër dhe banoj shume afër rasteve që veç kanë ndodhur pra jam kojshi i parë me rastin që ka ndodhur. Pra rasti parë që ka ndodhur nga reparti i dializës është ditur se ka ardh nga infermierja dhe e kemi ditur burimin por ky rasti që është paraqitur para dy dite nuk e di qysh po trajtohet dhe nëse është ai rasti në fakt fëmijët e tyre kanë pasur me fëmijët e e rastit të infermieres së dializës atëherë është para një muaji. Dhe tash gjate kësaj kohe shume kontakte kanë ndodhur si takime familjare, pra po ngriti si shqetësim se mos po na ndodhë ndonjë gjë e cila do të na befasoj mandej me na u paraqit pastaj raste të shumta, ngase ne jemi kojshi dhe ne fakt personalisht e kam respektuar në përpikëri çështjen e takimeve mirpo kom vërejt se ata si kojshi nuk i kanë respektuar dhe kanë pasur takime familjare dhe kojshi tjerë. Nuk kam informata se janë marrë mostra prej tyre që hiq me larg se njeri prej tyre para 3 dite ka qenë me Covid dhe ka qenë tek ne në zyre dhe ka kryer disa obligime dhe me sa e di unë është shitës i perimeve prandaj nuk po dua me alarmua absolutisht mirëpo nëse është ashtu siç po pretendohet si shume rrrezik atëherë nuk e di se a janë marrë masa të gjitha që për mos me ardh deri te ajo që mos me na ndodhë me u shpallë Rahoveci me pasoja në të ardhmen pra këtë çështje desha me ngritë kurse për të gjitha të tjerat ju falënderoj përzemërsisht dhe shprehi edhe ndjenjën e popullatës që janë shume mirënjohës në kontributin e komunës që keni qenë shume afër në menaxhimin e kësaj situate deri me tash por të mos e humbim ate momentin e fundit me na ndodh diçka që mos me muajt as ne se çka me bo. Faleminderit **Kryetari** – Rasti i para 3 ditëve e dimë edhe moshën edhe emrin e mbiemrin dhe menjëherë si të del rast pozitiv fillon gjurmimi i kontakteve, e në gjurmim të kontakteve na ndihmon shumë edhe QKMF-ja e posaçërisht përgjegjësinë e ka IKSHP-ja d.m.th. profesionistet e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike që janë mjaf aktiv, e në këtë rast përfshihet edhe Policia në gjithë këtë proces. Çdo fshehje e informacionit normalisht ne nuk mund ta dimë në sigurinë me të lartë se a po i thotë të gjitha apo po fsheh diçka. Kompetent për gjurmimin e kontakteve janë Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike, gati janë krejt hetues mirëpo kanë për detyrë me u marr me këtë punë dhe nëse dikush refuzon me dhanë përgjigje atëherë e kemi policinë pra janë organet tjera. Ne i kemi marr rastet e kontakteve për rastin për të cilin folët ju me herët, pasi ne e kemi obligim dhe siç e dini ne nuk i publikojmë emrat madje ka rekomandim edhe emrat e atyre që nëse vdesin nga Covid-19. Dhe unë nuk e kam respektua këtë të fundit pasi kur kemi pasur raste të vdekjes nga Covid, i kam shpreh ngushëllime familjeve dhe atë publikisht. Kontaktet janë gjurmuar dhe ai rasti i 7 punëtorëve shëndetësore për ja 4-5 ditë do rrinë të mbyllur edhe pse kanë dal negativ mbrëmë mirëpo do të rrinë të mbyllur dhe ne detyrohemë me marr veprime të caktuara në kompensimin e mungesave pasi na mungojnë 3 mjekë dhe 4 infermierë. Sigurisht nëse ka edhe gjurmë të kontakteve e tjera pra hetohen atëherë instituti kombëtar i shëndetësisë publike me bazë rajonale qoftë i Gjakovës d.m.th. varet se në cilat vende është rasti, nëse është nga pjesa e Prizrenit atëherë vinë nga Prizreni por kryesisht merret i Gjakovës për shkak se ne jemi në rajonin e Gjakovës por marrin pjesë ekipet e dy e rajoneve pra edhe të Prizrenit edhe të Gjakovës. Detyra e tyre është me i testua pra me ju marr mostrat edhe me i testua çdo rast kontakti, e kanë obligim ligjor. Në qoftë se ata mbërrin me i marr krejt sepse dikush edhe ka tentuar me i fshehë dhe sigurisht ne dimë diçka më shumë, ata unë i kisha sugjera me shkuat te drejtori i drejtorisë se shëndetësisë z. Samir Mustafa ose te drejtori i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare z. Jusuf Korenica edhe me paraqit rastin. Atëherë ne i shkrujmë IKSHP-së dhe ata vinë i marrin masat, por a vinë sot, nesër apo pasnesër ata e kanë sistemin e vetë po nëse ka raste te kontakti atëherë sigurisht që e kanë të obligueshme për me i marr mostrat. Kjo bëhet për një qellim të vetëm që me u izolua dhe me u mbyll qarku. Unë e kisha lutar edhe Hoxhën edhe secilin që dinë ma shumë sepse ndonjëherë neve na vjen marre me ju tregua të gjitha gjërat pasi ndonjëherë e mbajmë të fshehur edhe nga Policia, Prokuria apo edhe profesionisteve që merren me këtë punë por nëse dikush dinë për ndonjë rast atëherë është mirë me lajmërua edhe sigurisht që vinë ata, edhe nëse refuzojnë atëherë marrin asistencën edhe të policisë edhe shikojnë ja marrin mostrat. Pra kushdo që din atëherë ka një adresë pra adresa e komunës është drejtori i shëndetësisë Samir Mustafa apo Jusuf Korenica si përgjegjës po edhe nga unë edhe të gjithë drejtorët edhe ju mundeni me u adresua nëse mendoni se

njihni dikën edhe që duhet të i merren mostrat ndaj Covid-19. Realisht ndoshta ne kemi mungesë testesh në Kosovë por kushdo që dyshon diçka, sigurisht që ne kemi të drejtë me u paraqit edhe vetë edhe me thanë se unë po dyshoj se diçka nuk po ndihëm mirë edhe duhet të me merrni mostrën për tu testuar, e mos të flasim për raste kontakti që dikush ka pasur me këta kanë dalë pozitivë. Pra edhe unë jo si kryetar por si qytetar edhe me qemë Kosova pak me e fortë ne kuptimin e numrit të testeve, kom të drejtë edhe me ju thënë qe po du me u sigurua se nuk kam kurrgjë edhe po dua ta bëj testin. Përmes teje Hoxhë, po dua me ju thanë të gjithëve qe keni adresë dhe nëse dini diçka atëherë adresën e keni dhe ne i marrim masat tona dhe kërkojmë prej atyre që me ardhë me i marr mostrat aty ku dyshojmë. Përndryshe të shohim këta 6 pacientë që kanë dal pardje me Covid-19 dhe të shohim se sa kontakte i kanë pasur, pasi ende nuk e kemi listën e 6 pacienteve listën kontakteve të tyre sepse këtë listë e gjurmon dhe vërteton pasi kompetente është IKSHP-ja por kuptohet kërkon ndihmën e QKMF-së e sigurisht edhe tonën, e ne këtë rast edhe tuajën.

**Ilvi Shehu** – Përvendetje kryetar dhe gjithë ju të pranishëm në sallë. Jemi në prag të festës dhe kemi sugjerimet e bashkësisë islame që poashtu e falënderojmë shumë përbajtjen dhe këshillën e kryetarit të këshillit të bashkësisë islame të Kosovës. Unë në emër të komunitetit të tarikatit, kisha apelua që festa jonë nuk është e lehtë. Në kohën e luftës 99, ka qenë lufta mirëpo njerëzit kanë festuar, por e kemi pasur armikun i cili ka qenë përballë kurse sot është armiku i padukshëm dhe sot i bahesh armik i mikut tuaj, djalit, nuses, familjes. Kisha apelua edhe pse është kryemami këtu po ashtu edhe bashkësisë se Rufaive që të bëjmë apel që të përbahemi në kuptimin të ruhemit dhe të ruajmë dikën pastaj të bëjmë apel çdo njeri në familjet tona e posaçërisht te granimi që është traditë që 3 ditë apo një javë të festave të bëhet kontakte apo edhe të drekave të Bajramit, që për hir të fëmijëve dhe të gjithëve të izolohemi apo të vet izolohemi në familje. Po ashtu kisha lutar edhe komandantin edhe me falënderua për këtë kohë, unë edhe si pjesëtar i tarikatit por edhe si fermer apo si një njeri që nuk mundem me nejtë te shpija një sjellje që kanë dëshirua me punua e po ashtu edhe njerëzit që kanë shume të nervozuar edhe kanë dalë në pjesën e fushës për një sjellje që duhet lavdëruar por sigurisht që çdo vend nuk është mirë. Ata njerëzit që grumbullohen e që kam pae ehe vet pasi rrinë mbi 5 veta ne trotuar dhe kalon Polici edhe ju thotë se për qka po rrini ashtu grumbull. Pra kisha apelua që të gjithë që të ruhemit edhe te njerëzit të cilët e mbajnë peshën e popullatës që të shpjegojmë se nuk jemi kundër fesë por për shkak të situatës duhet me u ruajte. Faleminderit

**Sebajdin Durguti** – Faleminderit kryetar, unë deshta një informate me ju dhanë, teqeja e Rufaive nuk do të ketë dhe nuk ka pasur deri me tanë asnë aktivitet e po ashtu edhe në ditët e Bajramit nuk do të ketë aktivitete dhe nuk do të vinë popullata aty që të falet Bajrami, por është edhe apelë i Shehit që të mos shkohet nëpërshtëpi për urimet e festes se Bajramit siç e kemi pasur traditë deri tash. Pra për këtë Bajram kështu është marrë vendimi. Faleminderit

**Nysret Abazibra** – Unë këtë teme nuk desha me hapë duke menduar që duhet me ju lënë organeve kompetente mirëpo pasi që u hap krejt në rregull është edhe e përkrahi këtë iniciativë edhe këtë ide, se teke e fundit edhe ne si udhëheqës lokal të japim kontributin për lokalet tona. Ju siç e dini Bashkësia islame e Kosovës që nga dita e parë ka qenë në koordinim të plotë me institucionet shtetërore dhe nuk kanë qenë vendime të lehta që të merren mirëpo kur është në pyetje pasi edhe besimi i ynë na mëson që jeta e njerëzve duhet të jetë primare dhe na obligon me ruajt, prandaj edhe kemi marr vendime të cilat i kemi marr. Tani kemi plan pasi Ramazani kaloj dhe ju jeni dëshmitar se na kanë munguar shume sende dhe jemi mërzit shume por në të njëjtën kohë jemi pajtuar edhe jemi përshtat me rrethanat që na janë imponuar. Dhe tani është Bajrami para neve dhe është një sfidë për të cilën duhet kujdesshëm të menaxhohet, kemi zëra që kërkojnë hapjen e faltoreve dhe është shume absurde që dikush mos me kërkua mos me u hap por çdo kush ka të drejtë edhe duhet me kërkua me u hap mirëpo në momentin kur na japin kompetentet vendimin e tyre që nuk kanë kushte atëherë kjo temë duhet të mbyllët dhe nuk guxon të jetë temë që të bëjmë gara secili po del më fetarë se tjetri pasi të gjithëve po na dhimbset dhe të gjithë kemi qejf. Protestat që kanë simbolike krejt ne rregull pasi duhet me i marr si normale por assesi nuk duhet të kalohet ne veprime. Prandaj ne kemi dëgjuar edhe një iniciative se edhe ne komunën tonë disa të rinjtë me qellim të mirë kanë disa peticione dhe kërkesa që të falet Bajrami dhe

ne kemi bërë planë edhe me herët që nëse na lejohet që ta falim Bajramin në stadium apo në koordinim me komunën kemi pas dëshire me bo kërkesë mirëpo përderisa na erdhi vendimi se nuk banë atëherë kjo temë nuk diskutohet dhe iniciativa të tillë nuk guxojmë të lejojmë që të kalojnë në veprime, ngase tek e fundit përgjegjësin ma te madhe para zotit edhe pastaj para organeve i kemi ne udhëheqësit fetar edhe nëse ne marrim një qëndrim të tillë nuk është mirë që të tjerët të na dalin përpara për me marr ndonjë iniciativë. Prandaj është marr vendimi që Bajrami të mos falet në publik por me përgjegjësin me të plotë po ju them se para Bajramit, për neve e xhumaja është me e rëndësishme se Bajrami pasi falja e xhumasë është e rëndësishme se falja e Bajramit dhe të mos kapemi në tradita por të shohim në parime pra parimi i xhumasë është shume e rëndësishme. Pra përderisa xhumatë nuk po i falim atëherë Bajrami është më lehtë edhe pse neve na vjen me vështir për shkak se kemi dy herë ne vite mirëpo është me lehtë në aspektin fetar pasi nuk kemi përgjegjësi shumë nëse e krahasojmë me përgjegjësinë e xumasë, bilëm me na thonë dikush se cilën nga këto doni të falni atëherë ne kishim thënë që xhumanë po e falim kurse Bajramin po e lejmë, për shkak se Bajrami është në numër me te madhe njerëzish. Pra këto e mora një krahasim për me bo një sqa rim për peshën dhe vlerën që e ka. Unë propozoj në këtë rast kështu që nëse e shihni të arsyeshme edhe si komunë komunitetet fetare që jemi prezantë të dalim me një deklaratë të përbashkët që të i bëjmë apel popullatës edhe kryetari i Komunës edhe kryetari i bashkësisë islame por edhe dy shehlerët që i kemi në komunën tonë që në njëfarë mënyre të jetë një apel i përbashkët që përvëç që nuk falet Bajrami por edhe këto traditat për vizita që të kompensohen me mesazhe pra të ndalohen rreptësishtë vizitat. Pra ne po e marrim shembullin Meka që është drejtimi i ynë që drejtohami atje e kanë të ndaluar që në kohen e Bajramit që me dal jashtë po ashtu Turqia ka marr vendim që 4 ditë të Bajramit të jete orë policore pra të mos dilet kurkush jashtë e leje moh ne që jemi në njëfarë mënyre pak në periferi edhe ne këtë aspekt nuk guxojmë të i përzicjmë ndjenjat fetare dhe ta vëmë dikën sikurse është dikush kundra fesë, absolutisht që Shteti është i yni ,qeveria dhe institucionet janë tonat dhe ata janë për të mirën tonë dhe ne duhet të bëhem krah i tyre. Pra kaq kisha unë, ju faléminderit kryetar.

Bujar Morina – Unë dëshiroj të ju falënderoj për punën që keni bërë gjate kohës se pandemisë ju dhe stafi juaj pëq ashtu brengë ime është që prej 35 rasteve që i kemi në Komunën tonë se a është ndonjë rast nga komunitetet rom ashkali dhe egjiptian, duke ditur se këto 3 komunitete jetojnë edhe pa pandeminë ne kushte të vështira ekonomike dhe ju kisha lultur që kërkesa ime është që të i ndihmoni me pako higjenike dhe ushqimore familjet të cilat vërtet kanë nevojë për këto pako, megjithëse e di që nga komuna është ndihmuar shume dhe ju falënderoj të gjithëve stafit tuaj dhe juve kryetar. Faleminderit

Kryetari – Nuk ka ndonjë rast nga komuniteti rom ashkali dhe egjiptas raste me Covid, edhe pse kemi dyshuar për një person që u ardh te qika e vet por doli që nuk është e vërtet. Ne kemi marr masat edhe pse virusi nuk zgjedh secili është i varfër apo i pasur por besoj që me pako ushqimore jemi mirë dhe kemi të deponuara mjaft pako ushqimore këtu edhe higjenike e po ashtu edhe miell. Duhet të i gëzohemi faktit se prape po na lajmërohen edhe mullinjtë, qendrat e mëdha tregtare po ashtu edhe mërgimtarët që po ashtu edhe Bajram mund të këtë edhe donacione tjera, e pjesës ku jetojnë qytetaret që ndoshta kanë me shume nevojë e që janë në pozitë pak me te vështirë i kemi ndihmuar edhe me shume se 3 herë pra nuk kemi lënë asnjë familje pa e mbështetur, e që po besoj që do të vazhdoj kjo përpjekje. Unë i bashkohem apelit të 3 përfaqësuesve në këtë rast pra 3 përfaqësuesve të bashkësive fetare në komunën tonë, e kemi dëgjuar të gjithë me vëmendje edhe thirrjen, qëndrimin dhe pozicionin që e ka bashkësia islame e Kosovës pastaj pozicionin e institutit kombëtar të shëndetësisë publike për sa i takon festës se Bajramit të madhe. Ne jemi të vetëdijshëm besoj që të gjithë edhe për masën edhe rëndësinë që kanë festat fetare e ne këtë rast festa e Bajramit të madhe në komunën tonë dhe po ashtu jemi të vetëdijshëm se mbi 95% e festojnë dhe e kanë festuar gjithmonë, po ashtu jemi të vetëdijshëm se krahas urimeve që kemi për detyrë me ja bo njeri tjetrit edhe nga këtu ju uroj edhe ne emër të qytetareve dhe ju kam uruar edhe dje në televizionin 21 dhe i urojmë nga zemra krejt qytetaret e komunës se Rahovecit të besimit islam me rastin e festes se Fitër Bajramit duke ju kërkuar njëkohësisht që ta kenë sofrën plotë, begati dhe të gjitha të mirat në familjet e tyre dhe po ashtu duke i

respektuar dhe pas një vlerësim të lartë për ata që kanë agjëruar, qoftë i pranuar agjërimi edhe lutjet e përkushtimet e të gjithë qytetareve dhe gjithë njerëzve besimtarë, sikurse kemi kërkuar që të përbahen sa me shume edhe përfaljen e e Bajramit por edhe sidomos këto vizitat që sipas traditës familjet tona i bëjnë me njeri tjetrit. Rreziku me i madh është tek vizitat që janë të shumta viteve tjera kuptohet, e që sivjet duhet me ju përmbyt sepse është për të mirën tonë, e qytetareve tanë, besimtarë, faltoreve, xhamive, teqeve e po ashtu edhe përfenë ortodokse vlejnë edhe për ata njësoj sepse ky virus nuk po lyp as racë gjini e as përkatësi etnike e që vlejnë e njëjtë edhe përfshirë e Hoxhës Madhe, lagjes se epërmë nëse kanë ndonjë festë e që unë nuk e di tash. Por nëse është në interes me i hap faltoret tash pra me i bo funksionale me krejt ato çka duhet me i krye ne xhami e teqe në këtë rast, atëherë është mirë me ju përmbyt festave sepse shkurtohet koha dhe distanca e funksionalizimit të tyre dhe e njëjtë vlejnë dhe nëse ne i përbahemi atëherë shume me shpejt e kryejmë pandeminë por nëse nuk i përbahemi atëherë 14 ditë menjëherë ti merr dhe ai rast pastaj ti prodhon edhe shume raste tjera. Paramendoni nëse ne përbahemi përfshirë Bajram e respektojmë festën i gjëzojmë familjet tona dhe nuk ja shkurtojmë jetëgjatësinë pandemisë, sigurisht që telefonat funksionojnë po ashtu edhe interneti pra ka plot mundësi të urimit të ndërsjellët, kështu që është mirë me ju përmbyt aktivitete eve publike edhe vizitave familjare. Gjithsesi unë jam me juve dhe nëse është e nevojshme me bo edhe një thirrje pasi Policia e Kosovës ka me krye punën ve edhe nuk po besoj që kam me pas nevojë përfshirë me ndërmarr ndonjë masë sepse duhet me kuptua secili prej neve se kurrikush ska qejf me ju prish festa, atëherë meqenëse nuk ka qejf me ju prish festa duhet të rrnimë te shtëpitë tona dhe nga telefoni të i bëjmë urimet e ndërsjella me rastin e Fitër Bajramit pra duhet të pajtohem se vitet tjera kanë qenë ndryshe mirëpo ky vite është krejt ndryshe edhe duhet me respektua. Pra i bashkohem apelit edhe jam ne gjendje me bo një komunikatë bashke me juve, një deklarim apo postim dhe nga kjo mbledhje del një rekomandim nga Këshilli i KKSB-se që edhe festa e Bajramit sivjet festohet me ndryshe përfshirë shkak të gjendjes apo përfalljes me pandeminë Covid-19. Faleminderit shume për respektin kulturën edhe përvlerësimin edhe te bacës Ilvi, të përfaqësuesve të teqesë Helveticë, Rufaive edhe përfaqësuesit e bashkësisë islame në Rahovec. Besoj që janë dakord edhe anëtaret tjerë të KKSB-së pasi shumica dërmuese apo më mirë me thanë të gjithë qytetaret janë dakord përfshirë se pe dinjë edhe vetë së është më mirë kështu. Unë po e marr si rekomandim edhe normalisht edhe e bëj një postim të veçante edhe përfshirë çështje dhe nëse ka ndonjë media këtu ndoshta radio aktiv dhe kisha deshtë me marr një prononcime të veçante kur të dalim nga këtu të përfaqësuesve të bashkësive fetare dhe ku do të jemi bashkë edhe me komandantin e Policisë edhe i bashkohem apelit që të përbahen njerëzit me rastin e festes se Bajramit të madhe ose Fitër Bajramit. Faleminderit shume

Tani ka disa fjalë përbashërinë dhe reshjet intensive që kanë qenë ditëve të fundit që kanë qenë shume intensive dhe kanë dëmtua shumë në zona të caktuara. Në ditën e parë ishin relativisht të dendura mirëpo dëmet nuk konsiderohen të mëdha mirëpo ne ditën e dytë reshjet ishin shume të mëdha dhe me rrëbesh dhe kanë zgjatur me intensitet breshëri që në një zonë të caktuar e ka dëmtua dhe dëmet konsiderohen të mëdha p.sh. bjeshkën kësaj radhe nuk e ka dëmtua fare, zonën prej Celine e deri ne Kramovik nuk e ka prek fare mirëpo duke u afuar nga Prizreni që i bien që Krusha e Madhe është dëmtuar mjaft shume po ashtu edhe ne pjesën nga Zoqishti e Opterusha ka pasur dëme mirëpo kjo pjesa në kufi administrativ me Prizrenin është me e madhe. Ne kemi dal në terrenë menjëherë me ekipet tona natën po ashtu po atë natë kemi mbajtur takim emergjent edhe përfshirë pandeminë edhe për reshjet, kemi komunikuar me Ministrinë e Bujqësisë që kam një vlerësim shume pozitiv si njëri njëherë përi interesimin që po tregon se ndoshta nuk ka fuqi kurrgjë me na ndihmuar por ka ardhë dy here rresht dhe është interesua përfshirë komunën e Rahovecit kurse ditën e djeshme u ardh edhe vizitë direkt fizikisht edhe kemi dal e kemi pae nga afër se çka ka ndodhur se cilat janë pasojat dhe ato çka kemi pa me sy, vërtet është shume e rënd përfshirë ata që kanë punuar që sapo i kanë mbjellë fidanët dhe të gatshme përfshirë tregje që ju kanë dëmtuar edhe nuk kanë kurrgjë përfshirë këtë vite. Ne kemi formuar 5 komisione përfshirë evidencimin dhe vlerësimin sa me profesional të dhëneve, kemi edhe ekspertin e Ministrisë se Bujqësisë që merret me evidencimin dhe vlerësimin e dëmeve në vreshta pra posaçërisht në vreshta sepse ju e dini se ka kadastër të vreshtave por jo edhe përfshirë kultura perimtaria dhe të tjera por

të vreshtave ka edhe që është e angazhuar edhe Ministria e Bujqësisë që brenda pak ditësh do ta kemi edhe raportin e plotë të evidentimit sa me te plotë dhe maksimalisht sa me të saktë të dëmeve dhe vlerësimin sa me profesional vlerësimin financiar të dëmeve të shkaktuara nga breshëri dhe reshjet e dendura të shiu e përmbytjet që i kanë ndodhë komunës se Rahovecit brenda 48 orëve. Ne kemi raport të evidencës të vlerësimit edhe financiar por edhe listën emërore të të dëmtuarve nga erërat e forta që i dini më herët dhe nga ngricat që po ashtu i dini ma herët që i kemi pasur. Ne jemi duke pritur raportin pasi është shume herët tani me fol se sa i ka kushtua dhe cilat ishin pasojet reale te asaj që ka ndodhur në 48 orëve të fundit dhe sapo ta bëjmë raportin dhe do të io shkoj Ministrisë se Bujqësisë pastaj zyrës se Kryeministrat dhe shpresojmë që do të kemi ndërhyrje përmes mbështetjes apo përkrahjes nga fondi rezervë që ka edhe Ministria e Bujqësisë e që është fond i dedikuar nga fatkeqësitë elementare natyrore por gjithashtu ne kemi kërkuar që të pritet edhe ky fond për shkak se i kemi edhe 5-6 muaj këtë vitë që mundemi me pas përsëri dëme. Kemi kërkuar zyrtarisht që të përfshihen në pakon emergjente edhe ne pakon e rimëkëmbjes ekonomike fermerët dhe bujqit e Republikës se Kosovës e ne rastin konkret ne si komunë kemi kërkuar edhe kemi bërë temë edhe këtë çështje. Besoj që fermerët duhet me u trajtua pra shqetësimet e tyre me respekt dhe me seriozitetin ma të madhe edhe besoj që ka me ndodhë kompensim, tani është herët me fol por ne nuk do të ndalemë dhe kompensimi i dëmeve për fermerët kuptohet aq sa ka fuqi Kosova pasi përtet kapaciteteve që ka ne nuk dalim por do të kompensohen fermerët për dëmet e shkaktuara, nuk e di me q far vlore pasi nuk e kemi raportin sa është vlera e dëmeve dhe kemi me insistua me ngulmë me i futë në pakon ekonomike të rimëkëmbies edhe fermerët e komunës se Rahovecit. Tani është herët me garantua por ne këtë fryme po bëjmë përpjekjet edhe jam i bindur që kur të punojmë edhe sigurisht që shpresoj që do të kemi rezultate edhe besoj që kanë me pasur se paku një ndërhyrje nga shteti aq sa ka mundësi ky shtet me ju ndihmua fermerëve tanë. Po ashtu kemi kërkuar edhe rrjeta antibreshër, kemi kërkuar edhe veprime tjera që ndoshta nuk është momenti me i thanë por jemi në temë dhe kemi reaguar shpejt dhe e kemi bo të madhe për shkak se gjendja është e rëndë, jo pse na e kemi bërë të madhe dhe menjëherë qysh pasdite kemi filluar me i lëviz gjerat e që po besoj që kemi qenë në fryshtë e përgjegjësive tona si komunë. Dhe pritet me ndodh ndonjë veprim pozitiv në adresimin e këtyre situatave dhe shpresojmë se fermerët tanë përkundër humbjeve që i kanë për pandeminë mungesën e tregut e pastaj edhe dëmet që po ju shkaktohen do të fillojnë edhe do të kenë se paku disa rrethana lehtësuese edhe me ndërhyrjen e qeverisë edhe të shtetit. Ne si komunë do të vazhdojmë me implemtue programin për bujqësi që e kemi po ashtu fondin që edhe sivjet e kemi mbi 1 milion euro qysh e kemi pasur vitin e kaluar kurse ajo çka varet prej komunës ne do ta kryejmë punën tonë edhe jemi duke shkuar në atë drejtim. Nëse nuk ka dikush ndonjë koment pasi është edhe ditë e xhumta sot po ashtu është rasti me ju urua për ditën e Bajramit që po vjen edhe të gjithë atyre që kanë agjëruar lutjet përkushtimi dhe agjërimi të jetë i pranuar e urime Fitër Bajrami e u pafshim me të mira, e falënderoj posaçërisht përfaqësuesit e ushtrisë së Kosovës që janë prezantë.

Në sigurinë publike ndër etnike mendoj që prishja e vartezave apo dëmtimi nuk kanë karakter ndëretnik, unë kisha menduar e as besuar që mund të kenë karakter ndëretnik. E di që janë dëmtuar edhe me e herët disa varreza atje edhe kur ja kom kërkuar Ministrisë e që me mua ishte prezentë edhe nënkyetari aty dhe përgjigjen që ma kanë dhënë ata që e udhëheqin Ministrinë Kthimit dhe Komuniteteve janë munduar me ma ngatërrua pak dhe unë e kam thirr edhe ju kam thënë që mos shkruani asnjëherë në këtë mënyre pasi i kanë ngatërruar disa gjera që skanë lidhje me të sotmen e as me këto vitet e fundit edhe dëshirojnë ndonjëher që ka serb që punojnë ne institucionë të Kosovës që kanë motive tjera dhe qëllime tjera mirëpo ne nuk do të i pranojmë asnjëherë ato pretendime të tyre pasi nuk jemi papërvojë sa për të mos i kuptuar,. Nuk ka ndonjë rrezik që me marr ndonjë konotacion ndëretnik pasi gjendja është e qetë dhe stabile pasi ka bashkëjetesë dhe harmonie. Dhe ato qe e cenojnë sigurinë publike ndëretnike se paku nuk kam informatë që dikush ka përgatitë apo ka në planë me bo diçka apo me prishë këtë bashkëjetese, ndoshta dikush atje ne Beograd mendon me pas ndonjë ndërhyrje në prishjen e bashkëjetesës apo ne Prishtine që udhëhiqet nga Beograd me involvues dikën që me bo ndonjë problem por se paku në zonat ku ne operojmë nuk ka ndonjë situatë që mundet se

paku me na sfidua apo me na befasua në këtë momente. Ne do të përpinqemi me i trajtua qytetaret pa dallim siç i kemi trajtuar gjithmonë, do të ketë investime në çdo vend si në qytete edhe në fshatra, sigurisht edhe ne ato fshatra që kanë strukturë etnike të përzier, do të përpinqemi me i shfrytëza maksimalisht mundësitë tonë që çfarëdo halli që kanë qytetarët tanë edhe ata që janë pakicë sigurisht që ka një adresë, e për këtë adresë është komuna e Rahovecit pra është zyra komunale për komunitete me Lendritin me stafin e tij dhe jemi këtu pa asnje dallim me i trajtua të gjitha në mënyrë të barabartë ashtu siç trajtohen sipas ligjit sepse janë qytetarë të këtij vendi. Çdo tentativë me ardh nga jashtë diçka, besoj që bashke me Policinë dhe organet tjera do ta përcjellim me kujdes dhe nuk po besoj që ka më pasur ndonjë situatë që cenon marrëdhëniet ndëretnike ose njëfarë bashkëjetese që se paku përkundër asaj se çka ka ndodhë në Komunën e Rahovecit me mbi 1 mijë persona të vrarë e të zhdukur e shume të tjera, në asnjëherë nuk kemi pasur dhe nuk do të kemi konflikte ndëretnike sepse jemi popull i mirë dhe punëtorë pasi jemi popull i vjetër dhe kemi një trashëgimi shume të pasur dhe po sillemi shume mirë sigurisht edhe unë si kryetar komune edhe nuk ka asnje problem dhe kushdo që dëshiron me krijuar problem atëherë Shteti është këtu sigurisht edhe organet e shtetit po ashtu edhe Komuna e banë punën e vet. Për këtë askush nuk duhet të ketë frikë pasi jemi në vendin tonë dhe kushdo që dëshiron me jetua këtu mundet me jetua dhe sigurisht që ato që ju takojnë, i kanë të plotësuarë të gjitha të drejtat kushtetuese dhe ligjore pra edhe serbët edhe shqiptaret edhe të tjerët, që deri tash nuk ka pasurasnje problem dhe nuk besoj që do të ketë ndonjëherë.

Bujar Morina – I nderuari kryetar, deshta me vërtetua fjalimin tuaj se siguria në komunën e Rahovecit është pothuajse 99% në bashkëpunim me magjorancën është në nivel të duhur. Prej se jam anëtarë i këshillit të bashkësisë se sigurisë në komunën e Rahovecit nuk kemi pasur asnjëherë ndonjë rast specifikë me shumicën, kemi bashkëpunuar gjithmonë bashke brez pas brezi dhe për këtë arsyen unë e ceka me herët se personat të cilët nuk ja dojnë të mirën këtij vendi pra komunës tonë e kanë bërë një veprim të tillë të shëmtuar të cilin e dënojmë sepse dëshirojnë të ja prishin imazhin komunës tonë sepse gjithmonë ka qenë një ndër komunat më të mira në Republikën e Kosovës. Faleminderit  
 Kryetari – Unë po besoj që nuk do të ketë asnjëherë karakter të prishjes se raporteve ndëretnikë, unë ju falënderoj të gjithëve për kontributin dhe ju uroj të gjitha të mirat në familjet e juaja e me shëndet, uroj që krejt ndikimin tonë kudo që e kemi në përputhje me mundësitë ta ushtrojmë te secili edhe me përballua edhe me myllet ma shpejt pandeminë por edhe në pikëpamje tjera që të përapojmë edhe të kemi me shume suksese e mbarësi si komunë. Faleminderit shume për prezencën e njerezve që kanë ardhë po ashtu edhe nga përfaqësuesit e ushtrisë nga Ministria e Mbrojtjes që kanë dedikim me u marr me këtë temë për çështje të sigurisë nëpër komuna e që mbulojnë edhe komunën tonë, po ashtu edhe përfaqësuesve të bashkësive fetare, pastaj po ashtu edhe Komandantit të Policisë. Faleminderit të gjithëve dhe urime festa e Fitër Bajramit e paqit gëzime e shëndet në familjet e juaja. Faleminderit shume

Procesmbajtësi

Agim Hoti



Sinjalizati